REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 108/26 Dt. 05.03.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e realizimit të projektit: "Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Kontrata do të jetë dyvjeçare (kontratë kornizë).

3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural-mallra dhe shërbime.

4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.